KANTON
NIDWALDEN

Willkommen in Nidwalden
Informationen für Neuzuziehende

Mirësevini në Nidwalden
Informacione për të porsaardhurit

albanisch
deutsch

Përmbajtja	Inhalt	
Fjala përshëndetëse e Qeverisë	Grussbotschaft der Regierung	03
Mirësevini në Kantonin Nidwalden	Willkommen im Kanton Nidwalden	05
Nidwalden dhe Zvicra	Nidwalden und die Schweiz	05
Qëndrimi	Aufenthalt	06
Mësimi i gjuhës gjermane	Deutsch lernen	07
Takimet dhe koha e lirë	Begegnung und Freizeit	07
Puna	Arbeit	09
Familja	Familie	12
Shkolla	Schule	17
Arsimimi profesional	Berufsausbildung	21
Jetesa	Wohnen	21
Shëndeti	Gesundheit	24
Taksat	Steuern	28
Lëvizjet	Mobilität	29
Adresa dhe numrat e urgjencës	Adressen und Notfallnummern	31

IMPRESSUM
Herausgeber: Kanton Nidwalden
Gesundheitsförderung und Integration, Marktgasse 3, 6371 Stans
Redaktion / Text: Peter Hruza, Ylfete Fanaj, Brigitte Hüzeler
Konzept und Gestaltung: TRI**ART** GmbH, Stansstad
Bilder: TRI**ART**, Jonas Riedle / perretfoto, Christian Perret

© 2019, Kanton Nidwalden (überarbeitete Auflage)

FJALA PËRSHËNDETËSE E QEVERISË

Kantoni Nidwalden ndodhet ndërmjet liqenit Vierwaldstättersee dhe maleve. Pozicionimi gjeografik, si dhe afërsia me Lucernin, e bëjnë Nidwalden një vend tërheqës për të jetuar dhe punuar, duke ofruar cilësi të lartë jetese. Nidwalden është vendi i traditave nga më të ndryshmet, është i hapur ndaj së resë dhe ruan balancën ndërmjet traditës dhe inovacionit.

Ne tregojmë kujdes për Kantonin tonë. Për këtë duhet gatishmëria dhe përkushtimi i gjithësecilit, për një bashkëjetesë sa më paqësore. Bazë për këtë janë të drejtat dhe detyrimet e secilit, si dhe respekti reciprok. Në mënyrë që të arrini të komunikoni në punë, shkollë, kohën e lirë, apo me fqinjët, është e rëndësishme të mësoni gjuhën gjermane.

Ne ju ftojmë të përfitoni nga ofertat e shumëllojshme që mund të gjeni në vendbanimin tuaj të ri, si dhe të merrni pjesë në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore. Në këtë broshurë do të gjeni informacione të shumta mbi përditshmërinë dhe jetën në Kantonin tonë.

Ne ju urojmë mirëseardhjen dhe një fillim sa më të mbarë në Nidwalden, sa më shumë kënaqësi në zbulimin e bukurive të Kantonit dhe takime sa më interesante. Ne do të gëzoheshim, nëse ju ndjeheni mirë pranë nesh.

Michèle Blöchliger
Këshilltare e Qeverisë
Drejtoreshë për Çështjet Shëndetësore dhe Shoqërore
☞ www.nw.ch

GRUSSBOTSCHAFT DER REGIERUNG

Der Kanton Nidwalden ist eingebettet zwischen Vierwaldstättersee und Bergen. Die geografische Lage sowie die Nähe zu Luzern machen aus Nidwalden einen attraktiven Wohn- und Arbeitsort mit hoher Lebensqualität. Nidwalden kennt zahlreiche Bräuche, ist gleichzeitig offen für Neues und hält die Balance zwischen Tradition und Innovation.

Wir tragen Sorge zu unserem Kanton. Dies erfordert von jedem Einzelnen die Bereitschaft, sich für ein gutes und friedliches Zusammenleben einzusetzen. Grundlage dafür sind Rechte und Pflichten für alle sowie gegenseitiger Respekt. Damit Sie sich in der Schule, bei der Arbeit, in der Freizeit und mit den Nachbarn verständigen können, ist es wichtig, die deutsche Sprache zu erlernen.

Wir laden Sie ein, die vielfältigen Angebote an Ihrem neuen Wohnort zu nutzen und am sozialen, wirtschaftlichen und kulturellen Leben teilzunehmen. Sie finden in dieser Broschüre zahlreiche Informationen über den Alltag und das Leben in unserem Kanton.

Wir heissen Sie herzlich willkommen und wünschen Ihnen einen guten Start in Nidwalden, Freude beim Entdecken der Schönheiten unseres Kantons und viele interessante Begegnungen. Wir freuen uns, wenn Sie sich bei uns wohlfühlen.

Michèle Blöchliger
Regierungsrätin
Gesundheits- und Sozialdirektorin
☞ www.nw.ch

DIE SCHWEIZ UND NIDWALDEN



MIRËSEVINI NË KANTONIN NIDWALDEN

Ne gëzohemi që ju keni vendosur të jetoni pranë Kantonit Nidwalden. Shumë gjëra ju duken të panjohura dhe me siguri ju pyesni veten: Si do të mund të kuptohem me njerëzit? Çfarë ndodh nëse sëmurem? Çfarë do t'i ndihmonte fëmijët e mi, që më vonë të jenë të suksesshëm në punë? Si do të mund të njihem me njerëz tjerë?

Në këtë broshurë do të mund të gjeni udhëzime të rëndësishme, që do t'ju ndihmojnë të orientoheni shpejt në Nidwalden.

Shumë informacione të dobishme, në gjuhë të ndryshme, do të mund t'i gjeni edhe në internet:

- www.bsv.admin.ch
- www.sem.admin.ch
- www.migraweb.ch
- www.migesplus.ch

ⓘ Adresa të rëndësishme dhe numrat e emergjencës i gjeni në fund të broshurës. Gjithashtu, për çdo pyetje, ju ndihmon edhe stafi i administratës *(Gemeindeverwaltung)* së njësisë suaj.

NIDWALDEN DHE ZVICRA

Në Zvicër flitet gjuha gjermane, franceze, italiane dhe ajo retoromanike. Zvicra udhëhiqet nga një sistem demokratik dhe është e ndarë në 26 Kantone. Femrat dhe meshkujt kanë të drejta të barabarta dhe pakicat mbrohen. Kushtetuta mbron të drejtën e mendimit të lirë dhe të fesë.

Vendbanimi juaj i ri Nidwalden ka patur një histori të mbushur me ngjarje. Kantoni u popullua përpara më shumë se 5000 vitesh. Në shekullin e XIII ai ishte një ndër kantonet themeluese të Zvicrës. Gjatë formimit të Zvicrës moderne, në shekujt XVIII – XIX, ai u shndërrua në qendër konfliktesh intensive mes forcave liberale dhe konservatore. Sot Nidwalden ka arritur të kombinojë me sukses traditën me globalizmin. Njerëzit i ruajnë me kujdes këto tradita dhe gëzohen kur ju njiheni me traditat. Festa të rëndësishme janë karnavalet *(Fasnacht)* në shkurt/mars, të cilat karakterizohen nga muzika e gëzueshme, festa kombëtare në 1 gusht, festa të ndryshme në verë dhe vjeshtë, paradat e Santa Klausit në 6 dhjetor dhe sigurisht në Krishtlindje.

WILLKOMMEN IM KANTON NIDWALDEN

Wir freuen uns, dass Sie in den Kanton Nidwalden gezogen sind. Vieles wird neu für Sie sein und Fragen auslösen: Wie kann ich mich verständigen? Was passiert, wenn ich krank werde? Was hilft meinen Kindern, damit sie später im Beruf erfolgreich sind? Wie lerne ich andere Menschen kennen?

In der Broschüre finden Sie wichtige Hinweise, damit Sie sich rasch in Nidwalden orientieren können. Viele nützliche Informationen in verschiedenen Sprachen gibt es zudem im Internet.

- www.bsv.admin.ch
- www.sem.admin.ch
- www.migraweb.ch
- www.migesplus.ch

ⓘ Wichtige Adressen und Notfallnummern finden Sie ganz hinten. Gerne hilft Ihnen bei Fragen auch die Gemeindeverwaltung Ihrer neuen Wohngemeinde.

NIDWALDEN UND DIE SCHWEIZ

In der Schweiz spricht man Deutsch, Französisch, Italienisch und Rätoromanisch. Die Schweiz ist eine Demokratie und in 26 Kantone unterteilt. Frauen und Männer haben die gleichen Rechte und Minderheiten werden geschützt. Die Meinungs- und Religionsfreiheit ist durch die Verfassung garantiert.

Ihre neue Heimat Nidwalden kann auf eine bewegte Geschichte zurückblicken. Besiedelt wurde der Kanton Nidwalden vor über 5000 Jahren. Im 13. Jahrhundert gehörte er zu den Gründerkantonen der Schweiz. Während der Entstehung der modernen Schweiz im 18. und 19. Jahrhundert war er Schauplatz von intensiven Auseinandersetzungen zwischen konservativen und liberalen Kräften. Heute versteht es Nidwalden, mit Erfolg Traditionen und globale Öffnung zusammenzubringen. Die Menschen pflegen diese Traditionen mit Begeisterung und freuen sich, wenn Sie sich mit den Bräuchen bekanntmachen. Wichtige Anlässe sind die Fasnacht mit vielen Guggenmusig-Gruppen im Februar/März, der Nationalfeiertag am 1. August, verschiedene Schwing- und Älplerfeste im Sommer und im Herbst, die Samichlaus-Umzüge um den 6. Dezember und natürlich Weihnachten.

Kantoni përbëhet nga 11 njësi *(Gemeinden)*, me qendër në Stans. Në vitin 2017 popullsia e Nidwalden shënon 42 800 banorë. 14,2 përqind e tyre e kanë origjinën nga shtete të tjera. Nidwalden është një vend terheqës për të bërë biznes dhe mirëpret edhe dyqanet tradicionale, edhe ndërmarrjet moderne, si fabrikat e prodhimit të avionëve Pilatus, të cilat janë ndër më të mirat në botë në këtë fushë.

→ Të drejtat bazë

Zvicra dhe Kantoni Nidwalden i vlerësojnë shumë liritë, të drejtat dhe detyrat e çdo banori.

Baza për një bashkëjetesë të mirë janë konsiderata dhe toleranca reciproke, si dhe njohja e vlerave të njëjta bazë. Të drejtat bazë, si barazia e të drejtave apo liria e besimit, janë të shkruara dhe të theksuara në Kushtetutën e Zvicrës dhe në atë të Kantonit.

QËNDRIMI

→ Regjistrimi

Nëse vendoseni në Kantonin Nidwalden, do t'ju duhet të regjistroheni brenda 14 ditësh pranë Autoritetit të Drejtësisë/Departamenti i Migrimit *(Amt für Justiz/Abteilung Migration)*. Ky department do t'ju lëshojë një leje qëndrimi për të huajt.

✉ migration@nw.ch
☞ www.nw.ch > Migration

→ Ndryshimi i adresës

Nëse ndryshoni vendbanim brenda njësisë ose kantonit, duhet të informoni brenda 14 ditësh departamentin e migrimit mbi këtë ndryshim.

→ Bashkimi familjar

Shtetasit e EU/EFTA munden t'i tërheqin pjesëtarët e familjes, pavarësisht nga lloji i lejes së qëndrimit që kanë. Konsiderohen pjesëtarë të familjes bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit dhe fëmijët nën moshën 21 vjeç ose që janë nën varësinë e prindërve. Personat që vijnë nga shtete jashtë EU/EFTA mund të aplikojnë për tërheqje të anëtarëve të familjes (bashkëshort/bashkëshorte dhe fëmijë të pamartuar nën moshën 18 vjeç), pranë Autoritetit të Drejtësisë, sipas përkufizimit të ligjeve përkatëse. Informacione të detajuara dhe formularët e aplikimit mund t'i gjeni pranë Autoritetit të Drejtësisë/Departamenti i Migrimit.

Der Kanton besteht aus elf Gemeinden. Hauptort ist Stans. 2017 leben in Nidwalden 42 800 Menschen. 14,2 Prozent davon stammen aus anderen Ländern. Nidwalden ist ein attraktiver Wirtschaftsstandort mit traditionellem Gewerbe und innovativen Betrieben wie den Pilatus Flugzeugwerken, die im Flugzeugbau zur Weltspitze gehören.

→ Grundrechte

Die Schweiz und damit auch der Kanton Nidwalden legen Wert auf die Freiheiten, Rechte und Pflichten jedes Einzelnen. Die Basis für das gute Zusammenleben bilden gegenseitige Achtung und Toleranz sowie die Anerkennung der gleichen Grundwerte. Die Grundrechte wie Rechtsgleichheit, Gleichberechtigung oder Glaubensfreiheit sind in der Bundesverfassung und in der Kantonsverfassung festgeschrieben.

AUFENTHALT

→ Anmeldung

Wenn Sie in den Kanton Nidwalden ziehen, müssen Sie sich innert 14 Tagen beim Amt für Justiz/Abteilung Migration anmelden. Die Abteilung Migration wird Ihnen eine ausländerrechtliche Bewilligung ausstellen.

✉ migration@nw.ch
☞ www.nw.ch > Migration

→ Adressänderung

Wenn Sie innerhalb der Gemeinde oder des Kantons umziehen, müssen Sie innert 14 Tagen die Adressänderung der Abteilung Migration melden.

→ Familiennachzug

EU/EFTA-Staatsangehörige können in der Regel unabhängig von der Art ihrer Aufenthaltsbewilligung ihre Familienangehörigen nachziehen. Als Familienangehörige gelten Ehegattinnen und Ehegatten, Eltern und Kinder, die noch nicht 21 Jahre alt sind oder denen Unterhalt gewährt wird. Personen aus Staaten ausserhalb der EU/EFTA können unter Berücksichtigung der gesetzlichen Voraussetzungen beim Amt für Justiz/Abteilung Migration ein Gesuch um Familiennachzug (Ehegattinnen, Ehegatten und ledige Kinder unter 18 Jahren) einreichen. Detaillierte Informationen und Gesuchsformulare erhalten Sie beim Amt für Justiz/Abteilung Migration.

MËSIMI I GJUHËS GJERMANE

Në mënyrë që të integroheni sa më mirë këtu, është e rëndësishme që të kuptoheni me fqinjët, kolegët e punës ose mjekun tuaj. Kjo nuk është gjithnjë e lehtë. Banorët e Nidwalden flasin në jetën e përditshme me dialekt. Ai ka ndryshime nga gjermanishtja zyrtare dhe është i vështirë të kuptohet apo të mësohet. Megjithatë, të gjithë e kuptojnë gjermanishten zyrtare. Flisni gjermanishten zyrtare dhe pyesni, sa herë që nuk kuptoni diçka.

→ Kurse për gjuhën gjermane

Nëse ende nuk flisni aspak gjermanisht, ose dëshironi të përmirësoni njohuritë tuaja të gjermanishtes, duhet të merrni pjesë në një kurs të gjuhës gjermane. Për këtë ju vihen në dispozicion shumë kurse të ndryshme, në përshtatje me nevojat tuaja.

✉ bwz@nw.ch, ☞ www.netwalden.ch
☞ www.integration-nw.ch

→ Shërbimi i përkthimit (interpretimit)

Për biseda të rëndësishme e të vështira, këshillohet bashkëpunimi me një përkthyes/e. Shërbimi i përkthimit në Zvicrën qendrore merr përsipër veçanërisht përkthime në fushën e shëndetit, arsimit dhe sociale.

✉ info@dolmetschdienst.ch
☞ www.dolmetschdienst.ch

TAKIMET DHE KOHA E LIRË

Krahas shkollës dhe punës, edhe koha e lirë përbën një pjesë të rëndësishme të jetës së përditshme. Ajo përbën hapësirën për çlodhje dhe takime të reja. Në mënyrë që të kuptoheni, është e nevojshme të flisni gjermanisht (shiko "Mësimi i gjuhës gjermane"). Është e rëndësishme edhe që të kërkoni në mënyrë aktive kontakte me persona të tjerë.

→ Krijimi i kontakteve

Ju mund të krijoni kontakte me persona të tjerë në vendin e punës ose në vendbanim. Një tjetër mundësi për të njohur njerëz të rinj dhe për t'u integruar në shoqëri, është pjesëmarrja në një klub sportiv apo kulturor. Klubet janë shumë të preferuara në Nidwalden. Në uebsite-n e njësisë suaj gjeni në rubrikën

DEUTSCH LERNEN

Damit Sie hier heimisch werden ist es wichtig, dass Sie sich mit Ihren Nachbarn, den Arbeitskolleginnen oder Ihrem Arzt verständigen können. Das ist nicht immer einfach. Die Menschen in Nidwalden sprechen im Alltag einen Dialekt. Dieser unterscheidet sich vom Hochdeutschen und ist schwer zu verstehen oder gar zu erlernen. Das macht aber nichts, denn alle verstehen Hochdeutsch. Sprechen Sie einfach Hochdeutsch mit den Menschen und fragen Sie nach, wenn Sie etwas nicht verstehen.

→ Deutschkurse

Falls Sie noch gar kein Deutsch sprechen oder Ihre Deutschkenntnisse verbessern wollen, sollten Sie unbedingt einen Deutschkurs besuchen. Dazu stehen Ihnen viele auf Ihre Situation angepasste Kurse zur Verfügung.

✉ bwz@nw.ch, ☞ www.netwalden.ch
☞ www.integration-nw.ch

→ Dolmetschdienst

Für wichtige und schwierige Gespräche wird der Beizug eines Dolmetschers oder einer Dolmetscherin empfohlen. Der Dolmetschdienst Zentralschweiz übernimmt vor allem Dolmetschaufträge in den Bereichen Gesundheit, Bildung und Soziales.

✉ info@dolmetschdienst.ch
☞ www.dolmetschdienst.ch

BEGEGNUNG UND FREIZEIT

Neben Schule und Beruf bildet die Freizeit einen wichtigen Bestandteil des täglichen Lebens. Sie bietet Gelegenheit zu Entspannung und neuen Begegnungen. Damit Sie sich verständigen können ist es wichtig, dass Sie Deutsch sprechen (siehe «Deutsch lernen»). Wichtig ist auch, dass Sie aktiv den Kontakt mit anderen Menschen suchen.

→ Kontakt finden

Kontakte mit anderen Menschen finden Sie an der Arbeitsstelle oder im Wohnquartier. Eine weitere Möglichkeit, um Leute kennen zu lernen und sich in die Gesellschaft zu integrieren, ist das Mitmachen in einem Sport- oder Kulturverein. Vereine sind sehr beliebt in Nidwalden. Auf der Website Ihrer Gemeinde finden Sie un-

Koha e Lirë, Kultura (*Freizeit, Kultur*), një listë me shoqata. Sigurisht, aty mund të gjeni edhe një shoqatë, i cili do të përshtatej me talentet dhe nevojat tuaja.

→ Oferta për imigrantët

Në raste të veçanta, ka pika takimi të dedikuara për të huajt. Në këto vende, ka mentorë vendas, të specializuar për t'ju ndihmuar ju të integroheni në Nidwalden.

✉ gfi@nw.ch
☞ www.integration-nw.ch

→ Bashkësitë fetare

Në Nidwalden ka bashkësi fetare katolike dhe të reformuara, të cilat organizojnë aktivitete të ndryshme. Bashkësi të tjera fetare ka veçanërisht në Lucern.

☞ www.kath-nw.ch
☞ www.nw-ref.ch
☞ www.unilu.ch/rel-lu

→ Diskriminimi dhe racizmi

Nëse bëheni pre e racizmit, mund t'i drejtoheni Departamentit Kantonal për Mbështetjen e Shëndetit dhe Integrim *(Abteilung Gesundheitsförderung und Integration)*.

✉ gfi@nw.ch
☞ www.integration-nw.ch

PUNA

→ Gjetja e punës / Kërkimi për punë

Mundësia për hyrje në tregun e punës rregullohet me ligj dhe varet nga statusi i lejes së qëndrimit. Për të gjetur një punë kështillohet një kombinim i metodave të ndryshme të kërkimit:

- aplikoni për punët që gjeni të afishuara nëpër gazeta;
- kërkoni përshkrime të vendeve të punës në internet;
- dërgojuni aplikime direkt kompanive;
- vendosuni në kontakt me agjenci punësimi;
- flisni për këtë me personat që ju rrethojnë;
- regjistrohuni te zyrat rajonale të punës RAV OW-NW.

Një aplikim me shkrim për punë në Zvicër, përfshin CV-në (jetëshkrimin), letrën e motivimit si dhe dëshmi e referenca nga punët e mëparshme. Këshilla të dobishme për të

ter Freizeit, Kultur eine Vereinsliste. Und sicher auch einen Verein, der Ihren Talenten und Bedürfnissen entspricht.

→ Angebote für Zugewanderte

Vereinzelt gibt es Treffpunkte, die sich speziell an Ausländerinnen und Ausländer richten. Zudem gibt es einheimische Begleitpersonen, Mentorinnen und Mentoren, die Ihnen dabei helfen, sich in Nidwalden zurecht zu finden.

✉ gfi@nw.ch
☞ www.integration-nw.ch

→ Religionsgemeinschaften

In Nidwalden gibt es katholische und reformierte Religionsgemeinschaften, die Anlässe und Veranstaltungen organisieren. Weitere Religionsgemeinschaften sind vor allem in Luzern organisiert.

☞ www.kath-nw.ch
☞ www.nw-ref.ch
☞ www.unilu.ch/rel-lu

→ Diskriminierung und Rassismus

Werden Sie Opfer von Diskriminierung, können Sie sich an die kantonale Abteilung Gesundheitsförderung und Integration wenden.

✉ gfi@nw.ch
☞ www.integration-nw.ch

ARBEIT

→ Arbeit finden / Stellensuche

Der Zugang zum Arbeitsmarkt ist rechtlich geregelt und hängt vom Aufenthaltsstatus ab. Um eine Arbeit zu finden, ist eine Kombination verschiedener Suchmethoden empfehlenswert:

- bewerben Sie sich auf Stellenangebote in den Zeitungen;
- suchen Sie nach Stellenausschreibungen im Internet;
- versenden Sie Bewerbungen an Unternehmen;
- nehmen Sie mit Stellenvermittlungsbüros Kontakt auf;
- sprechen Sie Personen aus Ihrem Umfeld an;
- melden Sie sich beim Arbeitsvermittlungszentrum RAV OW-NW an.

Zu einer schriftlichen Bewerbung gehören in der Schweiz ein Lebenslauf, Motivationsschrei-

përgatitur një dosje aplikimi mund të gjeni në internet.

☞ www.berufsberatung.ch
☞ www.arbeit.swiss
✉ info@ravownw.ch, ☞ www.rav-ownw.ch

→ Leja e punës

Në mënyrë që të mund të punoni, ju duhet leja e punës. Kjo leje lëshohet nga zyra e punës (*Arbeitsamt*) me kërkesë të punëdhënësit. Nëse keni pyetje lidhur me lejen e punës, drejtojuni punëdhënësit tuaj.

✉ arbeitsamt@nw.ch
☞ www.nw.ch > Arbeitsamt

→ Të drejta dhe detyrime

Si punëmarrës/e keni të drejtë të pajiseni me kontratë pune, të paguheni sipas pagës së rënë dakord, të keni të paktën 4 javë leje në vit, afate të rregulluara të dorëheqjes/pezullimit nga puna, si dhe të pajiseni me referencë/dëshmi pune. Ndërkohë keni detyrimin të kryeni punën për të cilën keni rënë dakord me punëdhënësin. Informacione mbi kushtet e punës dhe të pagesës, mund të merrni pranë zyrës së punës ose sindikatave.

✉ arbeitsamt@nw.ch
☞ www.nw.ch > Arbeitsamt

→ Paga

Në Zvicër, paga juaj transferohet direkt në një llogari bankare. Ju mund të hapni llogari pranë një banke ose postës. Për këtë ju duhet pasaporta dhe leja e qëndrimit. Paga dokumentohet me një vërtetim page. Në këtë vërtetim paraqiten të detajuara paga bruto dhe neto, si dhe të gjitha shtesat dhe tatimet e sigurimet e mbajtura. Shtesa mund të jenë p. sh. pagesa për fëmijët. Ndërkohë nga paga bruto mund të mbahen: sigurimi për pension dhe për personat nën varësi që lë pas (AHV), sigurimi për invaliditet (IV), sigurimi për paaftësi për punë (EO), sigurimi për papunësi (ALV), sigurimi për aksidente jo në punë (NBU) dhe kontributet për pension (PK). Informacione të mëtejshme për sigurimet shoqërore gjeni në:

☞ www.ahv-iv.ch

Në varësi të llojit të lejes së qëndrimit, nga paga mbahet edhe tatimi në burim (shiko kapitullin "Taksat & tatimet"). Kontributet për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, në Zvicër nuk mbahen nga paga (shiko kapitullin "Shëndeti").

ben, Arbeitszeugnisse und Arbeitsbestätigungen. Nützliche Tipps zur Erstellung eines Bewerbungsdossiers erhalten Sie im Internet.

☞ www.berufsberatung.ch
☞ www.arbeit.swiss
✉ info@ravownw.ch, ☞ www.rav-ownw.ch

→ Arbeitsbewilligung

Damit Sie arbeiten dürfen, benötigen Sie eine Arbeitsbewilligung. Die Arbeitsbewilligung wird auf Antrag des Arbeitgebers vom Arbeitsamt ausgestellt. Bei Fragen zur Arbeitsbewilligung wenden Sie sich an Ihren Arbeitgeber.

✉ arbeitsamt@nw.ch
☞ www.nw.ch > Arbeitsamt

→ Rechte und Pflichten

Als Arbeitnehmer oder Arbeitnehmerin haben Sie das Recht auf einen Arbeitsvertrag, den vereinbarten Lohn, mindestens vier Wochen Ferien pro Jahr, einen geregelten Kündigungsschutz und ein Arbeitszeugnis. Dafür haben Sie die Pflicht, Ihre Arbeit wie vereinbart zu erbringen. Informationen zu den geltenden Lohn- und Arbeitsbedingungen erhalten Sie beim Arbeitsamt oder bei einer Gewerkschaft.

✉ arbeitsamt@nw.ch
☞ www.nw.ch > Arbeitsamt

→ Lohn

In der Schweiz wird der Lohn direkt auf ein Konto überwiesen. Sie können ein Konto bei einer Bank oder der Post eröffnen. Dazu brauchen Sie den Pass und den Ausländerausweis. Der Lohn wird jeweils auf einer Lohnabrechnung dokumentiert. Darauf sind Brutto- und Nettolohn und alle Zulagen und Abzüge im Detail vermerkt. Lohnzulagen können zum Beispiel Kinderzulagen sein. Abzüge werden für die Alters- und Hinterlassenenversicherung (AHV), die Invalidenversicherung (IV), die Erwerbslosenversicherung (EO), die Arbeitslosenversicherung (ALV), Nichtberufsunfall (NBU) und die Pensionskasse (PK) gemacht. Weiterführende Informationen zu Sozialversicherungen:

☞ www.ahv-iv.ch

Je nach Aufenthaltsstatus werden vom Lohn zudem Quellensteuern abgezogen (siehe Kapitel «Steuern»). Die Beiträge an die obligatorische Krankenversicherung sind in der Schweiz nicht Teil der Lohnabzüge (siehe Kapitel «Gesundheit»).

→ Diploma të huaja

Diplomat e huaja mund të njihen pranë një institucioni ose autoriteti të caktuar. Varet nga profesioni, se cili është institucioni përgjegjës për këtë. Për pyetje lidhur me diplomën tuaj, drejtojuni këshillimit professional ose studimor *(Berufs- und Studienberatung)*.

✉ bwz@nw.ch, ☞ www.netwalden.ch

→ Papunësia

Në rast papunësie, Zyra Rajonale e Punësimit (RAV) ju ndihmon dhe ju informon mbi përfitimet nga sigurimi për papunësinë. Pas humbjes së vendit të punës, drejtohuni sa më shpejt te komuna juaj. Më shumë informacione do të mund të merrni pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Obwalden Nidwalden *(RAV Obwalden Nidwalden)*.

✉ info@ravownw.ch, ☞ www.rav-ownw.ch

→ Afati për pushim nga puna

Ligji i mbron punëmarrësit prej pushimit nga puna, në rast sëmundjeje, aksidenti, shtatëzanie apo leje lindje. Pushimi nga puna në këto raste është i pavlefshëm. Nga ana tjetër, në raste të pushimit abuziv nga puna për arsye të tjera, punëmarrësi nuk mund të rikthehet në punë, por mund të bëhet i mundur dëmshpërblimi i tij, nëse vendoset kështu nga gjykata.

→ Puna në të zezë

Edhe një person që punon në fushën e pastrimit, kujdesit për fëmijët, për shtëpinë apo kopshtin, konsiderohet si nëpunës. Ai/ajo duhet të jetë i pajisur me leje pune për të huajt dhe të jetë i regjistruar pranë sigurimeve shoqërore (ose të sigurohet vetë), përndryshe bëhet fjalë për punë ilegale ose në të zezë. Një person që punon në të zezë, nuk është i siguruar në rast invaliditeti, aksidenti, apo papunësie. Pasojat mund të jenë dramatike. Është në interesin e gjithsecilit të jetë i regjistruar.

FAMILJA

Kantoni Nidwalden i mbështet familjet. Shërbime të ndryshme këshillimore ju ndihmojnë në rast pyetjesh apo në situata të vështira. Pikat

→ Ausländische Diplome

Ausländische Diplome können durch eine Behörde oder Institution anerkannt werden. Welche Behörde dafür zuständig ist, hängt vom jeweiligen Beruf ab. Für Fragen zu Ihrem Diplom wenden Sie sich an die Berufs- und Studienberatung.

✉ bwz@nw.ch, ☞ www.netwalden.ch

→ Arbeitslosigkeit

Im Falle von Arbeitslosigkeit hilft Ihnen das Regionale Arbeitsvermittlungszentrum (RAV) weiter und informiert Sie über die Leistungen der Arbeitslosenversicherung. Melden Sie sich nach Verlust der Arbeitsstelle so schnell wie möglich persönlich bei Ihrer Wohngemeinde. Mehr Informationen erhalten Sie beim Regionalen Arbeitsvermittlungszentrum Obwalden Nidwalden.

✉ info@ravownw.ch, ☞ www.rav-ownw.ch

→ Kündigungsschutz

Das Gesetz schützt Angestellte bei Krankheit, Unfall, Schwangerschaft oder Mutterschaft vor einer Kündigung. Eine Kündigung während dieser Sperrfrist ist in der Regel nichtig. Bei missbräuchlicher Kündigung aus anderen Gründen kann die oder der Angestellte hingegen nicht wieder in das Unternehmen eingegliedert werden; es kann einzig eine Entschädigung vor Gericht geltend gemacht werden.

→ Schwarzarbeit

Auch jemand, der für gelegentliche Arbeiten im Bereich Reinigung, Kinderbetreuung, Haus- und Gartenarbeiten bezahlt wird, gilt als erwerbstätig. Er oder sie muss im Besitz einer ausländerrechtlichen Bewilligung sein und bei den Sozialversicherungen angemeldet werden (oder sich selbst anmelden), ansonsten handelt es sich um illegale Arbeit oder um Schwarzarbeit. Eine Person, die schwarzarbeitet, ist im Falle von Invalidität, Unfall oder Arbeitslosigkeit nicht versichert. Die Folgen können dramatisch sein. Es liegt also im Interesse aller Arbeitnehmenden, angemeldet zu sein.

FAMILIE

Der Kanton Nidwalden unterstützt Familien. Verschiedene Beratungsstellen helfen Ihnen bei Fragen oder in schwierigen Situationen weiter.

e takimit apo klubet ju ofrojnë mundësinë të njihni familje të tjera, të shkëmbeni me to, apo të kaloni së bashku kohën e lirë.

Në Kantonin Nidwalden, Zyra për çështje civile *(Zivilstandsamt)* merret me regjistrimin e martesave, fëmijëve, raste lindjesh dhe vdekjesh.

→ Martesa

Në Zvicër duhet të jesh 18 vjeç, që të mund të martohesh. Para martesës fetare ju duhet të keni lidhur martesë pranë zyrës së gjendjes civile. Vlen e drejta e zgjedhjes së lirë të partnerit/partneres. Familjet apo persona të tjerë nuk kanë asnjë të drejtë të shtyjnë dikë drejt martesës. Zyra për çështje civile ju informon mbi kushtet për të kryer martesën dhe dokumentat e nevojshme për këtë qëllim.

Çiftet e së njëjtës gjini kanë të drejtën të bëjnë të njohur lidhjen e tyre, duke e regjistruar atë në Zyrën për çeshtje civile.

→ Lindjet

Lindjet duhet të regjistrohen pranë Zyres për çështje civile të vendit të lindjes brenda tri ditësh.

→ Rastet e vdekjeve

Rastet e vdekjeve duhet të regjistrohen pranë Zyres për çështje civile të vendit të vdekjes brenda dy ditësh.

✉ zivilstandsamt@nw.ch
☞ www.nw.ch > Zivilstandsamt
☞ www.zwangsheirat.ch

→ Shtatëzania/lindja

Në raste pyetjesh lidhur me planifikimin familjar, zyra përkatëse *(Fachstelle für Lebensfragen elbe)* e këshillimit ju vendoset në dispozicion.

✉ info@elbeluzern.ch
☞ www.elbeluzern.ch

Shoqërimin gjatë shtatëzanisë e merrni nga mjeku juaj i familjes ose një mami. Adresat mund t'i gjeni në numeratorin telefonik.

☞ www.local.ch
☞ www.hebamme.ch

→ Leja e lindjes

Pas lindjes, gratë e punësuara kanë të drejtën e një leje lindje prej të paktën 14 javësh. Gjatë kësaj periudhe, ato paguhen si rregull me 80% të pagës së tyre. Për këtë, ato duhet të kenë

Treffpunkte und Vereine bieten die Möglichkeit, andere Familien kennen zu lernen, sich auszutauschen oder die Freizeit gemeinsam zu verbringen.

Im Kanton Nidwalden ist das Zivilstandsamt Nidwalden für sämtliche Bereiche rund um Heirat, Kindsanerkennung, Geburt und Todesfälle zuständig.

→ Heirat

In der Schweiz muss man 18 Jahre alt sein, um heiraten zu können. Vor der religiösen Heirat, müssen sie zivilstandesamtlich geheiratet haben. Es gilt das Recht auf freie Wahl des Partners, beziehungsweise der Partnerin. Familien oder andere Personen haben demnach kein Recht, Frauen oder Männer gegen ihren Willen zu einer Heirat zu zwingen. Das Zivilstandsamt informiert Sie über die Voraussetzungen für die Eheschliessung und die dazu erforderlichen Unterlagen.

Gleichgeschlechtliche Paare haben die Möglichkeit, ihre Partnerschaft anerkennen zu lassen, indem sie diese auf dem Zivilstandsamt eintragen lassen.

→ Geburt

Geburten müssen beim Zivilstandsamt des Geburtsortes innert drei Tagen angemeldet werden.

→ Todesfälle

Todesfälle müssen beim Zivilstandsamt des Todesortes innert zwei Tagen angemeldet werden.

✉ zivilstandsamt@nw.ch
☞ www.nw.ch > Zivilstandsamt
☞ www.zwangsheirat.ch

→ Schwangerschaft/Geburt

Bei Fragen rund um die Familienplanung steht Ihnen die Fachstelle für Lebensfragen elbe zur Verfügung.

✉ info@elbeluzern.ch
☞ www.elbeluzern.ch

Begleitung in der Schwangerschaft erhalten Sie durch Ihren Hausarzt/Ihre Hausärztin oder eine Hebamme. Adressen finden Sie im Telefonverzeichnis.

☞ www.local.ch
☞ www.hebamme.ch

→ Mutterschaftsentschädigung

Nach der Geburt haben erwerbstätige Frauen Anspruch auf einen Mutterschaftsurlaub von mindestens 14 Wochen. In dieser Zeit erhalten Sie in der Regel 80 Prozent ihres Lohnes. Dazu

qenë të siguruara gjatë 9 muajve përpara lindjes dhe të kenë punuar për të paktën 5 muaj. Informacione të detajuara mund të merrni pranë fondit të kompensimit në Nidwalden *(Ausgleichskasse Nidwalden)*.

✉ info@aknw.ch, ☞ www.aknw.ch

müssen Sie während der neun Monate vor der Geburt versichert gewesen sein und während mindestens fünf Monaten gearbeitet haben. Detaillierte Informationen erhalten Sie bei der Ausgleichskasse Nidwalden.

✉ info@aknw.ch, ☞ www.aknw.ch

→ Fëmijët e vegjël

Për prindërit me bebe/fëmijë të vegjël, të gjitha njësitë ofrojnë këshillim falas për nënat dhe baballarët *(Mütter- und Väterberatung)*. Ky këshillim ofrohet nga persona të arsimuar, të cilët i këshillojnë prindërit lidhur me shëndetin, kujdesin, ushqimin dhe ju mbështesin për rritjen.

✉ muevae@spitexnw.ch
☞ www.spitexnw.ch > Dienstleistungen

→ Kleinkind

Für Eltern mit Säuglingen und Kleinkindern bis zu fünf Jahren bieten alle Gemeinden eine kostenlose Mütter- und Väterberatung an. Diese wird von ausgebildeten Fachpersonen geführt. Sie beraten Eltern bei Fragen zu Gesundheit, Pflege, Ernährung, Entwicklung und unterstützen sie bei der Erziehung.

✉ muevae@spitexnw.ch
☞ www.spitexnw.ch > Dienstleistungen

→ Grupet e lojërave *(Spielgruppe)*

Në të gjithë njësitë e banimit ka grupe lojërash. Fëmijët e moshës 3–4 vjeçare, që angazhohen në to, mund të luajnë, këndojnë, vizatojnë apo të bëjnë punë dore, të drejtuar nga një person i specializuar. Nëpërmjet lojërave, fëmijët përgatiten për në kopësht. Në këtë mënyrë, ata vendosen në kontakt me fëmijët e tjerë, mësojnë gjermanisht dhe zbaviten. Për më tepër, edhe prindërit njihen në këtë mënyrë me prindër të tjerë. Kjo ju ndihmon të përshtateni me vendbanimin e ri.

Adresat i gjeni në faqen e internetit të njësisë suaj të banimit.

☞ www.fks-nidwalden.ch

→ Spielgruppe

In allen Gemeinden gibt es Spielgruppen. Dort können Kinder im Alter von drei bis vier Jahren unter Anleitung einer Fachperson spielen, singen, malen und basteln. Die Kinder werden spielerisch auf den Kindergarten vorbereitet. Sie kommen in Kontakt mit anderen Kindern, lernen dadurch Deutsch und haben viel Spass. Eltern lernen zudem andere Eltern kennen. Das hilft Ihnen, sich an Ihrem neuen Wohnort gut einzuleben.

Adressen finden Sie in der Regel auf der Homepage Ihrer Wohngemeinde.

☞ www.fks-nidwalden.ch

→ Kujdesi për fëmijët

Nëse të dy prindërit janë të punësuar ose kanë nevojë për ndihmë, fëmijët mund t'i çojnë në kopësht ose në një familje që ofron kujdes për fëmijët. Fëmijët që ndjekin shkollën apo kopshtin kanë në shumë njësi banimi dhe mundësinë që të shkojnë në një nga qendrat e kujdesit për fëmijët pas orarit të shkollës. Kostot llogariten në përgjithësi sipas të ardhurave që kanë prindërit. Për informacione ju lutem drejtojuni ofertave të përkujdesjes.

☞ www.nw.ch > Kinderbetreuung

→ Kinderbetreuung

Sind beide Eltern berufstätig oder benötigen Sie eine Entlastung, so kann Ihr Kind im Vorschulalter in einer Kindertagesstätte oder einer Tagesfamilie betreut werden. Kindergarten- und Schulkinder haben in vielen Gemeinden die Möglichkeit, einen Hort oder einen Mittagstisch zu besuchen. Die Kosten richten sich meist nach der Höhe des Einkommens. Für Informationen wenden Sie sich direkt an die Betreuungsangebote.

☞ www.nw.ch > Kinderbetreuung

→ Ndihmat familjare

Të gjithë të punësuarit apo personat të vetëpunësuar, që jetojnë në Zvicër, kanë të drejtën e ndihmës familjare. Për fëmijët deri në moshën 16 vjeç (në rastin e fëmijëve të sëmurë apo me aftësi të kufizuara, të cilët nuk janë të aftë për punë, deri në moshën 20 vjeç) paguhet nga shteti një shumë prej 240 franga në muaj për çdo fëmijë. Për fëmijët e moshës

→ Familienzulagen

Alle Arbeitnehmenden und alle Selbstständigerwerbenden, die in der Schweiz wohnen, haben Anspruch auf Familienzulagen. Für Kinder bis 16 Jahre (bei kranken oder behinderten Kindern, die nicht arbeitsfähig sind, bis 20 Jahre) erhalten Sie eine Kinderzulage von 240 Franken je Kind und Monat. Für Kinder von 16

16 – 25 vjeç, që janë në shkollë, paguhet një shumë prej 270 franga në muaj për çdo fëmijë. Kërkesa për këto pagesa duhet të dorëzohet pranë punëdhënësit tuaj. Pyesni edhe nëse keni të drejtë të paguheni për fëmijët tuaj që jetojnë jashtë Zvicrës. Ndihmat familjare ju paguhen bashkë me pagën. Informacionë të mëtejshme mund të merrni pranë Zyrës së Kompensimit në Nidwalden *(Ausgleichskasse Nidwalden)*.

✉ info@aknw.ch, ☞ www.aknw.ch

→ Rritja e fëmijëve

Rritja e fëmijëve është një sfidë për të gjithë prindërit. Për këtë arsye, shumë prindër kërkojnë ndihmë nga persona të specializuar në këtë fushë. Këtë mund ta gjeni në zyrat e këshillimit të nënave dhe baballarëve *(Mütter- und Väterberatung)* ose të këshillimit për të rinjtë dhe familjet *(Jugend- und Familienberatung)*.

✉ muevae@spitexnw.ch
☞ www.spitexnw.ch > Dienstleistungen
☞ www.nw.ch > Jugendberatung

→ Probleme në Familje

Në çdo familje mund të ketë periudha të vështira. Zyrat e këshillimit për të rinjtë dhe familjet ju mbështesin, nëse keni pyetje lidhur me rritjen, apo probleme mes brezave.

✉ jugendberatung@nw.ch
☞ www.nw.ch > Familienberatung

→ Ndihmë në rastet e dhunës në familje

Dhuna në familje është fatkeqësisht një fenomen që ndodh. Dhuna fizike, psikologjike apo seksuale shkatërron familjen dhe është e dënueshme. Viktimat kanë të drejtë të këshillohen pa pagesë në një zyrë për këshillim dhe ndihmë ndaj viktimave të dhunës. Në kantonin e Nidwalden kjo ofrohet nga zyra e konsulencës së viktimave kantoni Lucernë.s Nëse bëhet fjalë për dhunë në shkallë të lartë, atëherë gratë dhe fëmijët e viktimizuar përfitojnë mbrojtje në Shtëpinë e Gruas Lucern *(Frauenhaus Luzern)*.

✉ justizamt@nw.ch
☞ www.disg.lu.ch > Opferberatung
✉ frauenhaus@frauenhaus-luzern.ch
✆ 24-Stunden-Notruf: 041 360 70 00
☞ www.frauenhaus-luzern.ch

→ Probleme financiare

Në rastet e problemeve financiare, shërbimi social *(Sozialdienst)* ju ofron këshillim për buxhetin, ndihmë në ristrukturimin e borxheve dhe menaxhimin e të ardhurave. Nëse edhe pas të gjitha përpjekjeve të ardhurat nuk mjaftojnë për mbulimin e jetesës, bis 25 Jahren, die in Ausbildung sind, eine Ausbildungszulage von 270 Franken je Kind und Monat. Sie müssen bei Ihrem Arbeitgeber einen Antrag auf Familienzulagen stellen. Klären Sie auch ab, ob Sie für Ihre im Ausland lebenden Kinder ein Anrecht auf Kinderzulagen haben. Familienzulagen werden mit dem Lohn ausbezahlt. Weitere Informationen erhalten Sie bei der Ausgleichskasse Nidwalden.

✉ info@aknw.ch, ☞ www.aknw.ch

→ Erziehung

Kinder und Jugendliche zu erziehen ist für alle Eltern eine Herausforderung. Viele Eltern suchen daher Unterstützung bei Fachpersonen. Diese finden sie bei der Mütter- und Väterberatung oder bei der Jugend- und Familienberatung.

✉ muevae@spitexnw.ch
☞ www.spitexnw.ch > Dienstleistungen
☞ www.nw.ch > Jugendberatung

→ Probleme in der Familie

In jeder Familie kann es schwierige Zeiten geben. Die Familien- und Jugendberatung unterstützt Sie, wenn Fragen zum Erwachsenwerden, Probleme zwischen den Generationen und im Familienleben zu lösen sind.

✉ jugendberatung@nw.ch
☞ www.nw.ch > Familienberatung

→ Hilfe bei häuslicher Gewalt

Häusliche Gewalt kommt leider vor. Zum Beispiel in Form von physischer, psychischer oder sexueller Gewalt. Sie zerstört die Familie und ist strafbar. Opfer von Gewalt haben Anrecht auf kostenlose Beratung durch eine Opferhilfeberatungsstelle. Für den Kanton Nidwalden macht dies die Opferberatungsstelle Kt. Luzern. Kommt es zu massiver Gewalt in der Familie, erhalten betroffene Frauen und deren Kinder Schutz und Beratung im Frauenhaus Luzern.

✉ justizamt@nw.ch
☞ www.disg.lu.ch > Opferberatung
✉ frauenhaus@frauenhaus-luzern.ch
✆ 24-Stunden-Notruf: 041 360 70 00
☞ www.frauenhaus-luzern.ch

→ Finanzielle Sorgen

Bei finanziellen Problemen bietet der Sozialdienst Budgetberatung, Hilfe bei der Schuldensanierung und freiwillige Einkommensverwaltung an. Falls trotz aller Bemühungen das Einkommen für die Deckung des Lebensunterkërkohet tek njësia e banimit ndihmë ekonomike. Ajo mbulon kostot për banesën dhe nevojat më të domosdoshme të jetesës.

☞ www.nw.ch > Sozialdienst

SHKOLLA

Shkolla publike quhet Volksschule. Frekuentimi i saj është i detyruar dhe shërbimi ofrohet falas. Përgjegjësinë në Zvicër për shkollat publike e kanë Kantonet. Si përgatitje para hyrjes në shkollë, fëmijët e moshës katër deri pesë vjeçare ndjekin kopshtet parashkollore gjatë një periudhe nga një deri në dy vjet. Shkollat u dërgojnë prindërve regjistrimin për në kopshtet parashkollore në mënyrë automatike. Pas periudhës parashkollore vijon arsimi fillor (nga klasa I deri në të VI). Pas klasës së gjashtë vijon arsimimi në shkollat orientuese ose shkollat e mesme kantonale. Gjuha zyrtare në shkolla është gjermanishtja standarde.

Pas mbarimit të kurseve/shkollave orientuese fëmijët mund të ndjekin arsimin profesional ose shkollat e mesme. Prindërit mund të vendosin të dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla private në vend të atyre publike. Shkollat private janë me pagesë. Nëse fëmija juaj ndjek një shkollë fillore private, prindërit kanë për detyrë të njoftojnë administratën e shkollës publike në njësinë e tyre të banimit.

Prindërit janë përgjegjësit kryesorë për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre. Ju jeni të detyruar të regjistroni fëmijët tuaj në shkollë dhe të siguroheni se ata janë në rregull për sa i përket frekuentimit të shkollës dhe respektimit të orarit dhe rregullave të shkollës. Prindërit duhet të sigurohen që fëmijët e tyre bëjnë detyrat e shtëpisë. Bashkëpunimi mes shkollës dhe prindërve është me rëndësi të madhe në Zvicër dhe është pjesë e shkollimit. Prindërit ftohen rregullisht nga shkolla për biseda dhe mbrëmje takimesh.

→ Shkolla e mesme *(Mittelschule)*

Shkollë e mesme mund të jetë një gjimnaz apo kolegj. Studimet në shkollën e mesme kurorëzohen me një diplomë mature që të jep të drejtën për të vazhduar studimet në të gjitha universitetet dhe shkollat e larta profesionale *(Universitäten und Fachhochschulen)*. Për të fituar të drejtën e ndjekjes së shkollës së mesme, një mesatare e mirë është kusht i detyrueshëm.

halts nicht ausreicht, wird bei der Wohnsitzgemeinde wirtschaftliche Sozialhilfe beantragt. Sie deckt den nötigsten Lebensunterhalt und angemessene Wohnungskosten ab.

☞ www.nw.ch > Sozialdienst

SCHULE

Die öffentliche Schule heisst Volksschule, ist obligatorisch und kostenlos. In der Schweiz sind die Kantone für die Volksschule zuständig. Zur Vorbereitung auf die Schule besuchen die vier- bis fünfjährigen Kinder ein bis zwei Jahre lang den Kindergarten. Die Schule schickt den Eltern die Kindergartenanmeldung automatisch zu. Danach folgt die Primarschule (1. bis 6. Klasse). Nach der 6. Klasse erfolgt der Übertritt in die Orientierungsschule oder die kantonale Mittelschule. Offizielle Schulsprache ist Hochdeutsch.

Nach der Orientierungsschule beginnt Ihr Kind eine Berufsausbildung oder besucht eine Mittelschule. Es steht den Eltern frei, ihr Kind statt in die Volksschule in eine private Schule zu schicken. Private Schulen sind kostenpflichtig. Wenn Ihr Kind während der obligatorischen Volksschulzeit eine private Schule besucht, haben Sie die Pflicht, dies der Schulverwaltung Ihrer Wohngemeinde zu melden.

Die Eltern sind hauptverantwortlich für die Erziehung und Ausbildung ihrer Kinder. Sie sind verpflichtet, ihre Kinder einzuschulen und darauf zu achten, dass sie den Schulbesuch, den Stundenplan und die Schulordnung einhalten. Eltern müssen sicherstellen, dass die Kinder ihre Hausaufgaben machen. Die Zusammenarbeit zwischen Schule und Eltern hat in der Schweiz zentrale Bedeutung und ist Teil der Schulbildung. Eltern werden von der Schule regelmässig zu Elterngesprächen und Elternabenden eingeladen.

→ Mittelschule

Die Mittelschule entspricht dem Gymnasium oder College. Sie führt zu einem Maturitätszeugnis, das zum Studium an allen Universitäten und Fachhochschulen berechtigt. Für den Zugang zur Mittelschule ist ein guter Notendurchschnitt erforderlich.

BILDUNGSSYSTEMATIK



→ Gjermanishtja si gjuhë e dytë (DaZ)

Kur fëmija juaj pranohet në shkollë me njohuri të kufizuara të gjuhës gjermane, shkolla ofron forma të ndryshme mbështetjeje. Së pari, fëmijët integrohen në klasa të rregullta dhe pastaj fillojnë të marrin mësime shtesë të gjuhës gjermane. Masat e duhura në këto raste merren nga mësuesit dhe personat përgjegjës brenda DaZ.

✉ bildungsdirektion@nw.ch
☞ www.nw.ch > DaZ

→ Deutsch als Zweitsprache (DaZ)

Wenn Ihr Kind mit geringen Deutschkenntnissen in die Schule eintritt, bietet die Schule verschiedene Formen der Unterstützung an. In erster Linie werden Kinder in die Regelklasse integriert und erhalten zusätzlich Deutschunterricht. Die passenden Massnahmen werden von der Lehrperson und der Verantwortlichen für DaZ getroffen. Informationen zur Schule erhalten Sie beim Amt für Volksschulen und Sport.

✉ bildungsdirektion@nw.ch
☞ www.nw.ch > DaZ

ARSIMI PROFESIONAL

Zvicra ka një sistem shumë të suksesshëm të arsimit professional i cili adaptatohet në mënyrë të vazhdueshme edhe nga vende te tjera.

→ Zgjedhja e profesionit tek të rinjtë

Konsulentët për punën dhe profesionet mbeshtesin studentët në procesin e zgjedhjes së një profesioni. Për këshillim individual është e nevojshme të regjistrohesh në zyrën për këshillim karriere dhe studimesh *(Berufs- und Studienberatung)*. Kjo zyrë vihet gjithashtu në dispozicion të të rriturve që janë para një zgjedhjeje të një profesioni të ri.

✉ biz@nw.ch, ☞ www.netwalden.ch

→ Arsimi dhe aftësimi bazë professional

Shumica e të rinjve në Zvicër zgjedhin trajnime me orientim profesional dhe arsim bazë kryesisht profesional. Kjo përfshin jo vetëm trajnimin praktik në një kompani, por edhe ndjekjen e shkollës profesionale. Dëshmia profesionale hap rrugën në botën e punës si edhe në formim të mëtejshëm profesional. Të rinjve të interesuar dhe të talentuar në mënyrë të vecantë u bëhet i mundur diplomimi i plotë në shkolla të mesme profesionale. Kjo mundëson më vonë studimin në shkolla të larta profesionale dhe në kushte të caktuara edhe studimin nëpër universitete.

→ Oferta tranzicionare *(Brückenangebote)*

Për të rinjtë që nuk kanë mundësi të fillojnë trajnimin e duhur profesional pas mbarimit të nivelit dytësor I, ekzistojnë disa oferta te ashtuquajtura të përkohshme.

→ Trajnime për të rriturit

Të rriturit mund të bëjnë trajnime profesionale të njohura në Zvicër. Këto mund të kryhen në formën e një trajnimi profesional bazë ose nëpërmjet kursesh profesionale plotësuese *(Nachholbildung)*. Rekomandohet fort edhe frekuentimi i trajnimeve të mëtejshme, në mënyrë që të gjeni veten në tregun e punës.

✉ biz@nw.ch, ☞ www.netwalden.ch

BANIMI

→ Kërkim banesash

Nëse jeni duke kërkuar një banesë të re, ju mund të gjeni afishime banesash në gazetën ditore «Nidwaldner Zeitung», gazetën falas «Unterwaldner» ose «Blitz», ose edhe në internet. Për shembull vizitoni faqet:

BERUFSAUSBILDUNG

Die Schweiz verfügt über ein sehr erfolgreiches und im Ausland mehrfach kopiertes System der Berufsausbildung.

→ Berufswahl für Jugendliche

Berufsberaterinnen und Berufsberater unterstützen Schülerinnen und Schüler bei der Berufswahl. Für die Einzelberatung ist eine Anmeldung bei der Berufs- und Studienberatung erforderlich. Diese steht auch Erwachsenen zur Verfügung, die sich beruflich neu orientieren wollen.

✉ biz@nw.ch, ☞ www.netwalden.ch

→ Berufliche Grundbildung

Die Mehrheit der Jugendlichen in der Schweiz macht eine berufsorientierte Ausbildung, meist eine berufliche Grundbildung. Dazu gehört neben der praktischen Ausbildung in einem Betrieb die Berufsfachschule. Der Berufsabschluss öffnet den Weg in die Arbeitswelt und in höhere Fachausbildungen. Besonders interessierte und begabte Jugendliche können an der Berufsfachschule die Berufsmaturität ablegen. Diese ermöglicht ein Studium an einer Fachhochschule und unter bestimmten Voraussetzungen den Zugang zu den Universitäten.

→ Brückenangebote

Für Jugendliche, denen es im Anschluss an die Sekundarstufe I nicht gelingt, direkt eine Berufsausbildung zu beginnen, stehen so genannte Brückenangebote zur Verfügung.

→ Ausbildung für Erwachsene

Auch Erwachsene können eine in der Schweiz anerkannte Berufsausbildung machen. Dies kann in Form einer beruflichen Grundbildung oder einer so genannten Nachholbildung geschehen. Sehr empfohlen wird auch der Besuch von Weiterbildungen, damit die Arbeitsmarktfähigkeit bleibt.

✉ biz@nw.ch, ☞ www.netwalden.ch

WOHNEN

→ Wohnungssuche

Falls Sie eine neue Wohnung suchen, finden Sie Wohnungsinserate in der Tageszeitung «Nidwaldner Zeitung», den Gratisanzeigern

www.immoscout24.ch
www.anzeiger.ch

→ Kontrata e qirasë

Si rregull, një kontratë qiraje me shkrim përfshin të dhëna rreth objektit ose pronës që jepet me qera, tarifave të qerasë, datave të përfundimit të kontratës, depozitimit të garancise, kushtet e përgjithshme dhe rregullat e komunitetit. Qiraja paguhet në përgjithësi paraprakisht për muajin e ardhshëm. Zakonisht qiraja që paguhet përfshin kosto shtesë të tilla si për ngrohje, ujë ose televizion kabllor. Informohuni nëse shpenzimet tuaja për qiranë përfshijnë apo jo kosto shtesë. Gjatë procesit të dorëzimit ose marrjes së një banese rekomandohet që së bashku me pronarin të kontrollohet gjendja e banesës dhe defekte të mundshme të shënohen me shkrim në një regjistër. Regjistroni edhe dëmet e vogla.

→ Tarifat për përdorimin e radios dhe TV

Përveç qirasë së banesës, çdo familje duhet të paguajë tarifa për përdorim pajisjesh që shërbejnë për marrjen e sinjalit të programeve radiofonike dhe/ose televizive (p.sh. TV, radio makine ose celularët).

info@serafe.ch
www.serafe.ch

→ Tarifat e furnizimit me ujë dhe energji

Për përdorimin e energjisë elektrike, ujit dhe kanalizimeve, faturat dërgohen nga kompanitë e shërbimeve përkatëse.

→ Fqinjët

Prezantohuni me fqinjët tuaj pasi të keni marrë një banesë të re. Kjo do t'ju vlerësohet. Njerëzit në Nidwalden janë zakonisht të vetëpërmbajtur. Megjithatë ekziston një traditë e mirë, që fqinjët të ndihmojnë njëri-tjetrin. Edhe ju do të ndihmoheni. Thjesht pyesni nëse keni nevojë për ndihmë apo nuk kuptoni diçka.

→ Rregullat e komunitetit

Në shumicën e shtëpive me qira ekzistojnë rregullat e komunitetit, të cilat duhet të respektohen. P.sh., respektimi i qetësisë së natës ora 22 – 07 ose pushimit të drekës ora 12 – 13 është shumë i rëndësishëm. Kush dëshiron të organizojë një festë, këshillohet të lajmërojë fqinjët e tij paraprakisht. Për përdorimin e një dhome të përbashkët lavanterie ka në shumicën e rasteve një plan përdorimi.

«Unterwaldner» oder «Blitz» oder im Internet. Zum Beispiel:

www.immoscout24.ch
www.anzeiger.ch

→ Mietvertrag

In der Regel wird ein schriftlicher Mietvertrag abgeschlossen, der den Umfang des Mietobjektes, Mietkosten, Kündigungstermine, Mietkaution, die allgemeinen Bedingungen und die Hausordnung enthält. Die Miete wird im Allgemeinen im Voraus für den nächsten Monat bezahlt. Meist zahlen die Mietenden zusätzliche Nebenkosten, zum Beispiel für Heizung, Wasser oder Kabelfernsehen. Informieren Sie sich, ob Ihre Mietkosten mit oder ohne Nebenkosten angegeben sind. Bei der Wohnungsübergabe beim Ein- und Auszug empfiehlt es sich, gemeinsam mit dem Vermieter den Zustand der Wohnung zu prüfen und allfällige Mängel schriftlich in einem Protokoll festzuhalten. Halten Sie auch kleine Schäden fest.

→ Radio- und TV-Gebühren

Zusätzlich zur Wohnungsmiete muss jeder Haushalt Empfangsgebühren für Geräte bezahlen, mit denen es möglich ist, Radio- und/oder TV-Programme zu empfangen (zum Beispiel TV, Autoradio oder Handys).

info@serafe.ch
www.serafe.ch

→ Strom- und Wassergebühren

Für Strom, Wasser und Abwasser erhalten Sie eine Rechnung von den Versorgungsbetrieben.

→ Nachbarinnen und Nachbarn

Stellen Sie sich nach Ihrem Einzug in die neue Wohnung bei Ihren Nachbarinnen und Nachbarn vor. Das wird geschätzt. Menschen in Nidwalden sind eher zurückhaltend. Es gibt aber eine grosse Tradition, dass sich Nachbarn gegenseitig helfen. Auch Ihnen wird geholfen. Fragen Sie einfach, wenn Sie Hilfe brauchen oder etwas nicht verstehen.

→ Hausordnung

In den meisten Mietshäusern oder -wohnungen gibt es eine Hausordnung, die beachtet werden muss. Beispielsweise ist die Nachtruhe von 22 bis 07 Uhr und die Mittagsruhe von 12 bis 13 Uhr einzuhalten. Wer Feste feiern will, kündigt dies am besten bei seinen Nach-

→ Sigurimi i banesës dhe familjar

Sigurimi i banesës dhe ai i përgjegjësisë personale nuk janë të detyrueshëm ne Zvicër, por rekomandohet të paguhen. Sigurimi i banesës rimburson dëmtimin e objekteve shtëpiake të shkaktuara nga zjarri, uji, vjedhje apo thyerje xhamash. Sigurimi i përgjegjësisë personale rimburson shpenzime që rrjedhin nga lëndime personale apo dëme materiale të shkaktuara nga personi i siguruar. Për një krahasim primesh të sigurimeve të ndyrshme mund të vizitoni

☞ www.comparis.ch

→ Sigurimi i detyrueshëm i pronës

Nidwalden ka një sigurim të detyrueshëm për pronën. Sigurimi i pronës Nidwalden SPN siguron godinat dhe automjetet nga zjarri apo rreziqe të tjera elementare. Formularët e regjistrimit dërgohen drejtpërsëdrejti nga kompanitë e sigurimit.

☞ www.sichere-sache.ch

→ Mbledhja e mbeturinave

Mbeturinat administrohen të ndara. Pikat e shitjes pranojnë mbetje shishesh, bateri dhe paketime plastike. Në njësitë e banimit ekzistojnë qendra grumbullimi të mbeturinave, ku ju mund të hidhni shishe qelqi, kanaçe dhe materiale të tjera. Letra dhe kartoni ju merren para shtëpisë në intervale të caktura. Mbetjet e tjera hidhen në thasë të veçantë, të cilët janë të disponueshëm kundrejt një pagese. Ju mund ti blini këta thasë mbeturinash në kasat e supermarketeve ose në zyrat e postës. Shumë njësi banimi dërgojnë kalendarë të mbledhjeve të mbeturinave, me datat dhe orët e sakta të grumbullimit në to.

☞ www.suibr.ch

SHËNDETI

Sistemi shëndetësor zviceran është kompleks dhe jo i lehtë të kuptohet, madje edhe nga vendasit. Udhëzuesi i shëndetit, i botuar nga kryqi i kuq zviceran *(Schweizerisches Rotes Kreuz)* jep shumë informacione. Ai është botuar me kërkesë të Zyrës Federale të Shëndetësisë *(Bundesamt für Gesundheit)* dhe ka si qëllim afrimin e imigrantëve në Zvicër me

barn an. Für die Nutzung einer gemeinsamen Waschküche gibt es in den meisten Fällen einen Benutzungsplan.

→ Hausratversicherung und Privathaftpflichtversicherung

Hausratversicherung und Privathaftpflichtversicherung sind in der Schweiz nicht obligatorisch, aber empfehlenswert. Die Hausratversicherung vergütet Schäden am Hausrat, die durch Feuer, Wasser, Diebstahl und Glasbruch entstehen. Die Privathaftpflichtversicherung vergütet Sach- und Personenschäden, welche die versicherte Person verursacht. Einen einfachen Prämienvergleich zwischen den Versicherungen finden Sie unter

☞ www.comparis.ch

→ Obligatorische Sachversicherung

Nidwalden hat eine obligatorische Sachversicherung. Die Nidwaldner Sachversicherung NSV versichert Gebäude und Fahrhaben gegen Feuer- und Elementarrisiken. Sie erhalten die Anmeldeformulare direkt von der Versicherung zugestellt.

☞ www.sichere-sache.ch

→ Abfallentsorgung

Der Abfall wird getrennt entsorgt. Verkaufsstellen nehmen PET-Flaschen, Batterien und Plastikverpackungen zurück. In den Gemeinden gibt es Abfallsammelstellen, an denen Sie Glasflaschen, Aluminiumdosen und andere Altstoffe entsorgen können. Papier und Karton werden zu bestimmten Terminen vor dem Haus abgeholt. Der Restabfall wird in gebührenpflichtigen Abfallsäcken entsorgt. Diese Abfallsäcke erhalten Sie an der Kasse der Supermärkte oder am Postschalter. Viele Gemeinden verschicken einen Abfallkalender mit den genauen Sammeldaten und -zeiten.

☞ www.suibr.ch

GESUNDHEIT

Das Schweizer Gesundheitswesen ist komplex und auch für Einheimische nicht immer leicht zu verstehen. Der Gesundheitswegweiser des Schweizerischen Roten Kreuzes liefert viele Informationen. Er ist im Auftrag des Bundesamts für Gesundheit entwickelt worden und möchte in der Schweiz lebenden Migrantinnen und Migranten den Zugang zu Gesundheits-

kujdesin shëndetësor, sigurimin shëndetësor dhe ndaj aksidenteve, si dhe informimin mbi oferta të ndryshme për kujdes ndaj shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Udhëzuesin e Shëndetit e gjeni këtu

☞ www.migesplus.ch

→ Ndihma mjekësore

Në Zvicër jeni të lirë të zgjidhni mjekun tuaj. Megjithatë, në varësi të llojit të modelit të sigurimit shëndetësor, zgjedhja mund të jetë e kufizuar në një kategori të caktuar mjekësh. Së pari, është mjeku i familjes ai që ofron ndihmën e parë mjekësore. Më pas, nëse është e nevojshme, ju drejtojnë tek mjekët specialist. Adresat e mjekëve të familjes i gjeni në numeratorin telefonik.

☞ www.local.ch > Ärzte

Gjatë natës dhe në fundjavë funksionon shërbimi i urgjencës. Në raste urgjente ose kur është i nevojshëm shtrimi në spital, do të merrni kujdesin mjekësor në spital.

→ Sigurimi shëndetësor: sigurimi bazë

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, i quajtur edhe sigurimi bazë mbulon shërbimet ligjore themelore në rastet e sëmundjeve, aksidenteve apo ne rastet e lejes së lindjes. Ai është i detyrueshëm për çdo person që jeton në Zvicër pavarësisht nga mosha, origjina dhe lloji i lejes së qëndrimit. Afati maksimal për t'u regjistruar është 3 muaj pas lindjes ose vendosjes në Zvicër. Në Zvicër funksionojnë mbi 50 kompani sigurimi. Të gjitha ofrojnë të njëjtat shërbime në paketën e sigurimit bazë por ato ndryshojnë nga ofertat e shërbimit. Kompanitë e sigurimit janë të detyruara të ofrojnë për këdo paketën bazë të sigurimit. Ju jeni të lirë të zgjidhni kompaninë që dëshironi.

→ Sigurimi shëndetësor: sigurime suplementare vullnetare

Krahas sigurimit bazë, jeni të lirë të zgjidhni edhe për sigurime suplementare; p.sh. të mbulohen telat e dhëmbëve tek fëmijët, syzet dhe lentet e kontaktit, shtrimi në spitalet private ose gjysmë private, zgjedhja e lirë e mjekut në spital, ose terapitë e mjekësisë alternative. Sigurimet suplementare duhet të paguhen ndaras. Sa më shumë shërbime të mbulojnë policat e sigurimit tuaj, aq më të shtrenjta janë ato. Për informacione të mëtejshme, drejtojuni kompanive të sigurimit.

versorgung, Kranken- und Unfallversicherung sowie zu Angeboten der Gesundheitsförderung und Prävention erleichtern. Den Gesundheitswegweiser finden Sie unter

☞ www.migesplus.ch

→ Medizinische Hilfe

Sie haben in der Schweiz freie Arztwahl. Je nach gewähltem Krankenkassen-Modell kann die Wahlfreiheit jedoch auf bestimmte Ärzte und Ärztinnen beschränkt sein. Die ärztliche Versorgung wird in erster Linie durch Hausärztinnen und Hausärzte sichergestellt. Bei Bedarf werden Sie an Spezialisten verwiesen. Adressen von Hausärztinnen und Hausärzten finden Sie im Telefonverzeichnis.

☞ www.local.ch > Ärzte

Während der Nacht und am Wochenende besteht ein ärztlicher Notfalldienst (041 610 81 61). In dringenden Notfällen oder wenn ein Aufenthalt im Spital nötig ist, werden Sie in den Krankenhäusern ärztlich versorgt.

→ Krankenkasse: Grundversicherung

Die obligatorische Krankenpflegeversicherung, auch Grundversicherung genannt, deckt die gesetzlichen Grundleistungen im Fall von Krankheit, Unfall und Mutterschaft. Sie ist für jede in der Schweiz wohnhafte Person obligatorisch, unabhängig von Alter, Herkunft und Aufenthaltsstatus. Die Anmeldefrist beträgt drei Monate nach Geburt oder Wohnsitznahme in der Schweiz. In der Schweiz gibt es über 50 Krankenkassen. Jede Krankenkasse bietet in der Grundversicherung die gleichen Leistungen an, sie unterscheiden sich aber im Serviceangebot. Die Krankenkassen müssen jede Person in die Grundversicherung aufnehmen. Sie können die Krankenkasse frei wählen.

→ Krankenkasse: Freiwillige Zusatzversicherungen

Die Zusatzversicherung kann freiwillig, zusätzlich zur Grundversicherung abgeschlossen werden; zum Beispiel für Zahnstellungskorrekturen bei Kindern, Brillen und Kontaktlinsen, für die stationäre Behandlung in der halbprivaten oder privaten Abteilung, die freie Arztwahl im Spital oder für alternativmedizinische Therapien. Zusatzversicherungen müssen separat bezahlt werden. Je mehr Leistungen Sie versichern, umso teurer wird die Prämie. Für weitere Informationen wenden Sie sich an die Krankenkassen.

→ Primet e sigurimit shëndetësor

Për sigurimin shëndetësor, paguhet çdo muaj një prim. Sipas ligjit për fëmijët deri në moshën 18 vjeç, primet janë më të ulëta. Për moshat 19–25 vjeç, kompanitë e sigurimeve mund të ofrojnë çmime të reduktuara. Kompanitë e sigurimit përcaktojnë çdo vit nivelet e primeve. Niveli i primit (kontributi) ndryshon në varësi të vendbanimit, moshës, modelit të sigurimit dhe ekskluzivitetit.

☞ www.priminfo.admin.ch/de/praemien

Kompanitë e sigurimit ofrojnë modele të ndryshme kursimi, mes të cilave ju jeni të lirë të zgjidhni: niveli franchise vjetor apo përzgjedhja e një modeli alternativ sigurimi (Modeli i mjekut të familjes, HMO («Health Maintenance Organization»), apo telemjekësi. Informohuni direkt te kompania juaj e sigurimit mbi modelet e ndryshme të sigurimit. Për më tepër ju keni mundësi edhe ta ndërroni kompaninë tuaj të sigurimit, në mënyrë që të kurseni primet. E rëndësishme: shkëputja duhet të bëhet jo më vone se dita e fundit e punës së muajit Nëntor, tek kompania juaj e sigurimit. Nëse ju jeni pjesë e modelit tradicional, të siguruar me primin minimal të lejuar ligjërisht prej 300 frangash, atëherë ju mund të shkëputeni nga kompania e sigurimit edhe në fund të qershorit. Atëherë shkëputja ndodh jo më vonë se dita e fundit e punës së muajit Mars. Kërkesën për prishje kontrate duhet t'ia dërgoni kompanisë së sigurimit me letër rekomande.

→ Ndarja e kostove (Franchise, mbulimi vetjak dhe pagesa e spitalit)

Sipas legjislacionit zvicerian të siguruarit në kuadër të sigurimit bazë shëndetësor (mjek, spital dhe medikamente) gëzon të drejtën: Franchise: Shuma që duhet të paguajë i siguruari, para se siguracioni të marre përsipër rimbursimin (minimalisht 300 franka për të rriturit, 0 franga për fëmijët). Vetë mbulim: Nëse faturat e shërbimeve shëndetësore të marra gjatë vitit, tejkalojnë Franchise-n, atëherë kompania e sigurimit merr përsipër

pjesën tjetër. Megjithatë, edhe i siguruari duhet të mbulojë vetë 10 % të kësaj shume (maksimalisht 700 franga në vit): Kjo pjesë quhet mbulimi vetjak. Kostot spitalore: Në rastin e shtrimit në spital, kostot e trajtimit ato të fjetjes dhe ushqimit mbulohen nga siguracioni shëndetësor bazë. Ligji për

→ Krankenkassenprämien

Die Prämie wird (im Prinzip monatlich) vom Versicherten an die Krankenkasse bezahlt. Laut Gesetz müssen alle Krankenkassen eine tiefere Prämie für Kinder bis zum 18. Altersjahr anbieten. Bei den jungen Erwachsenen (19 bis 25 Jahre) kann die Krankenkasse eine reduzierte Prämie anbieten. Jedes Jahr legen die Krankenkassen die Höhe der Prämien fest. Die Höhe der Prämien (Beiträge) ist abhängig von Wohnort, Alter, Versicherungsmodell und Franchise. Es lohnt sich, die Prämien zu vergleichen.

☞ www.priminfo.admin.ch/de/praemien

Krankenkassen bieten verschiedene Sparmöglichkeiten an, die Sie frei wählen können: Die Höhe der Jahresfranchise oder die Wahl eines alternativen Versicherungsmodells (Hausarztmodell, HMO [Health Maintenance Organization]) oder Telmed. Informieren Sie sich direkt bei Ihrer Krankenkasse über die verschiedenen Versicherungsmodelle.

Sie haben zudem die Möglichkeit, Ihre Krankenkasse zu wechseln, um Prämien zu sparen. Wichtig: Die Kündigung muss spätestens am letzten Arbeitstag im November bei Ihrer Krankenkasse eintreffen. Wenn Sie im traditionellen Modell, mit der gesetzlichen Mindestfranchise von 300 Franken versichert sind, ist auch eine Kündigung auf Ende Juni möglich. Dann muss die Kündigung spätestens am letzten Arbeitstag im März eintreffen. Schicken Sie die Kündigung per Einschreiben an die Krankenkasse.

→ Kostenbeteiligung (Franchise, Selbstbehalt und Spitalbeitrag)

Die schweizerische Gesetzgebung bestimmt, dass die Versicherten sich im Rahmen der Grundversicherung an den Gesundheitskosten (Arzt, Spital und Medikamente) beteiligt:

Franchise: Der vom Versicherten zu zahlende Betrag, bevor die Versicherung die Vergütung übernimmt (mindestens 300 Franken für Erwachsene, 0 Franken für Kinder).

Selbstbehalt: Sobald die beanspruchten Gesundheitskosten den Betrag der Franchise überschreiten, übernimmt die Krankenkasse die Vergütung der Leistungserbringer. Der Versicherte trägt jedoch weiterhin 10 Prozent der Rechnungsbeträge (maximal 700 Franken pro Jahr): Dieser Anteil wird Selbstbehalt genannt.

Spitalkostenbeitrag: Bei einem Spitalaufenthalt sind die Behandlungskosten und die Kos-

sigurimin shëndetësor kërkon një shumë edhe për kostot spitalore. Të siguruarit mbi 26 vjeç duhet të paguajnë 15 franga çdo ditë. Fëmijët dhe të rriturit nën 26 vjeç si edhe gratë me leje lindje janë të çliruar nga këto detyrime.

→ Subvencionimet kantonale të primeve

Të siguruarit që ndodhen në gjendje të vështirë ekonomike kanë të drejtë të kërkojnë subvencionim të një pjese të primeve. Regjistrimi bëhet në zyrën e kompensimit (*Ausgleichskasse Nidwalden*).

✉ info@aknw.ch, ☞ www.aknw.ch

→ Sigurmi ndaj aksidenteve

Të gjithë të punësuarit në Zvicër sigurohen që në ditën e parë të punës në mënyrë të detyrueshme ndaj aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Nëse punoni më shumë se sa 8 orë në javë, siguroheni edhe ndaj aksidenteve jo në punë. Edhe punëtorët ndihmës në shtëpi apo personeli i pastrimit duhet të sigurohen nga punëdhënësi. Edhe të papunësuarit sigurohen me detyrim. Të vetëpunësuarit, që punojnë në biznese familjare, duhet të sigurohen vullnetarisht ndaj aksidenteve në punë. Të pasiguruar janë shtëpiaket/shtëpiakët, fëmijët, nxënësit/studentët dhe pensionistët. Sigurimi nga aksidentet është i detyrueshëm.

→ Sigurimi për kujdes paraprak për të moshuarit, invaliditetin dhe sëmundjet profesionale

Zvicra ka një sistem të diferencuar për kujdesin paraprak ndaj të moshuarve dhe ofron mbështetje në rast sëmundjesh apo invaliditeti. Informacione të detajuara mund të merrni pranë zyrës së kompensimit në Nidwalden.

✉ info@aknw.ch, ☞ www.aknw.ch

TAKSAT DHE TATIMET

Në Zvicër, kostot për shërbimet publike si infrastruktura, trafiku, ushtria, policia, arsimi/shkollat, shëndeti, siguria shoqërore, kultura dhe sporti mbulohen kryesisht nëpërmjet të ardhurave të mbledhura nga tatimi mbi të ardhurat apo mbi pronësinë e individëve, taksimi i bizneseve dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

→ Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhurat në Zvicër mblidhet si nga qeveria qendrore, ashtu edhe nga Kantonet dhe njësitë e banimit. Masa e tatimeve vendoset nëpërmjet një deklarimi vjetor. Zyra e taksave në kantonin tuaj dërgon si rregull çdo vit në muajin Shkurt formularin e deklarimit për efekt tatimi. Tek udhëzimet është shkruar sesi duhet plotësuar dhe dorëzuar ky formular. Nga viti 2020 do jetë e mundur plotësimi dhe dërgimi i tij në mënyre dixhitale.

→ Tatimi në burim

Në raste të caktuara, tatimet mbahen direkt nga paga. Në këtë rast, punëdhënësi i paguan direkt tatimet. Tatimpaguesi merr një pagë të reduktuar me shumën e tatimit. Kjo vlen veçanërisht në rastin e punonjësve të huaj, të cilët jetojnë në Zvicër, por nuk zotërojnë një leje qëndrimi.

☞ www.steuern-nw.ch

TRANSPORTI

→ Në këmbë ose me biçikletë

Biçikleta është shumë e preferuar në Zvicër. Rrugët e biçikletave janë të shënuara mirë, në mënyrë që përdoruesit e biçikletave të mund të lëvizin sa më lehtësisht. Këshillohet të bëni një sigurim për përgjegjësinë, i cili do t'ju mbronte në rast dëmesh ndaj të tretëve. Edhe këmbësorët duhet të ecin në mënyrë të sigurt. Tek vijat e bardha, këmbësorët kanë prioritet.

☞ www.pro-velo.ch

→ Transporti publik

Rrjeti i transportit publik në Zvicër është ndër më të dendurit në botë. Të gjitha njësitë lidhen me këtë rrjet. Me anë të një aboneje Halbtax-Abonnement për trenat zviceranë (SBB), biletave për shumë udhëtime, aboneve mujore apo vjetore, mund të përdorni trenat, autobusat dhe anijet me çmime të reduktuara.

☞ www.passepartout.ch

ten für Unterkunft und Verpflegung durch die Grundversicherung gedeckt. Das Krankenversicherungsgesetz verlangt jedoch einen Spitalkostenbeitrag. Versicherte ab 26 Jahren bezahlen einen Beitrag von 15 Franken pro Tag. Kinder und junge Erwachsene in Ausbildung unter 26 Jahren sowie Frauen im Fall der Mutterschaft sind von diesem Beitrag befreit.

→ Kantonale Prämienverbilligungen

Versicherte, die in bescheidenen finanziellen Verhältnissen leben, haben Anspruch auf eine Verbilligung ihrer Krankenkassenprämien. Die Anmeldung erfolgt bei der Ausgleichskasse Nidwalden.

✉ info@aknw.ch, ☞ www.aknw.ch

→ Unfallversicherung

Alle in der Schweiz beschäftigten Arbeitnehmenden sind ab dem 1. Tag ihrer Arbeitsaufnahme obligatorisch gegen Unfälle und Berufskrankheiten versichert. Falls Sie mehr als acht Stunden pro Woche arbeiten, sind Sie auch bei Nichtbetriebsunfällen versichert. Auch Heimarbeitende, Haushalthilfen und Putzpersonal in Privathaushalten müssen durch die Arbeitgebenden versichert werden. Arbeitslose Personen sind weiterhin grundsätzlich obligatorisch versichert. Selbstständigerwerbende Personen und Familienmitglieder, die im Familienbetrieb mitarbeiten, sollten sich freiwillig in der beruflichen Unfallversicherung versichern lassen. Nicht versichert sind nicht erwerbstätige Personen wie Hausfrauen und Hausmänner, Kinder, Studierende, Rentnerinnen und Rentner. Sie müssen sich in der obligatorischen Krankenpflegeversicherung gegen Unfall versichern.

→ Alters- und Invalidenversicherung, berufliche Vorsorge

Die Schweiz verfügt über ein differenziertes System zur Altersvorsorge und bietet Unterstützung bei Krankheit und Invalidität. Detaillierte Informationen erhalten Sie bei der Ausgleichskasse Nidwalden.

✉ info@aknw.ch, ☞ www.aknw.ch

STEUERN

In der Schweiz werden die Kosten für die öffentlichen Leistungen wie Infrastruktur, Verkehr, Armee, Polizei, Bildung/Schule, Gesundheit, soziale Sicherheit, Kultur und Sport hauptsächlich aus den Einkommens- und Vermögenssteuern der Privatpersonen, der Besteuerung der Unternehmen und der Mehrwertsteuer bezahlt.

→ Einkommenssteuern

Einkommenssteuern werden in der Schweiz sowohl vom Bund (direkte Bundessteuer) als auch von den Kantonen und Gemeinden (Kantons- und Gemeindesteuern) erhoben. Die Höhe der Steuern wird anhand einer jährlichen Steuererklärung festgestellt. Das Kantonale Steueramt verschickt in der Regel jährlich im Februar die Steuererklärung. In der Wegleitung ist beschrieben, wie die Steuererklärung auszufüllen und einzureichen ist. Ab 2020 ist eine vollständig digitale Erstellung und Einreichung der Steuern möglich.

→ Quellensteuer

Bei gewissen steuerpflichtigen Personen werden die Steuern direkt vom Lohn abgezogen. In diesem Fall werden die Steuern direkt vom Arbeitgeber bezahlt. Der Steuerpflichtige erhält eine um den Steuerbetrag gekürzte Lohnauszahlung. Dies betrifft insbesondere ausländische Angestellte, die in der Schweiz leben und nicht im Besitz einer Niederlassungsbewilligung sind.

☞ www.steuern-nw.ch

MOBILITÄT

→ Zu Fuss und mit dem Velo unterwegs

Das Fahrrad (Velo) ist in der Schweiz beliebt. Velowege sind gut markiert, damit sich Velofahrer sicher fortbewegen können. Es wird empfohlen, eine Haftpflichtversicherung abzuschliessen, die Sie bei Schäden gegenüber Dritten mit dem Velo versichert. Auch wer zu Fuss unterwegs ist, soll möglichst sicher durch den Verkehr kommen. Fussgängerinnen und Fussgänger haben auf Zebrastreifen grundsätzlich Vortritt.

☞ www.pro-velo.ch

→ Öffentlicher Verkehr

Die Schweiz verfügt über eines der weltweit dichtesten öffentlichen Verkehrsnetze. Alle Gemeinden sind an dieses Netz angeschlossen. Mit einem Halbtax-Abonnement der Schweizerischen Bundesbahnen (SBB), Mehrfahrtenkarten, Monats- oder Jahreskarten können Sie

www.sbb.ch

→ Makinat / Motorrët

Një patentë të huaj duhet ta konvertoni brenda një viti pas mbërritjes në Zvicër në patent zvicerane. Nëse keni një mjet udhëtimi jashtë vendit dhe do të dëshironit ta importonit atë në Zvicër, keni një vit kohë nga momenti i mbërritjes, për të regjistruar mjetin tuaj në Zvicër.

✉ info@vsz.ch, www.vsz.ch

→ Carsharing

Carsharing është përdorimi i përbashkët i një ose më shumë makinave. Makina të tilla mund të gjeni nëpër të gjithë Zvicrën. Në ndryshim nga marrja me qira e makinës, kjo mënyrë bën të mundur edhe përdorimin e mjetit për një kohë mjaft të shkurtër, p.sh. disa orë. Ofruesi më i madh është Mobility me më tepër se sa 2600 mjete.

www.mobility.ch

→ Biçikleta publike

Në shumë komuna në Nidwalden ju keni mundësi të merrni biçikleta me qira. Ju duhet të regjistroheni në aplikacionin «Nextbike», qiraja kushton 2 CHF për orë.

www.nextbike.ch

ADRESA DHE NUMRAT E URGJENCËS

→ Numra të urgjencës

Policia	117/112
Zjarrfikësi	118/112
Ambulanca	144
Urgjenca për raste helmimesh	145
Helikopteri i shpëtimit REGA	1414

→ Adresa

Gesundheitsförderung und Integration
Marktgasse 3, 6371 Stans
041 618 75 90
✉ gfi@nw.ch
www.nw.ch/gfi
www.integration-nw.ch

→ Adresa në Internet

www.info-merkblatt.ch
www.local.ch
www.nw.ch > Online-Schalter > Rat und Hilfe

Bahn, Busse und Schiffe in der ganzen Schweiz zum reduzierten Preis benützen.

www.passepartout.ch
www.sbb.ch

→ Auto/Motorrad

Einen ausländischen Führerausweis müssen Sie innerhalb eines Jahres nach dem Einreisedatum in einen Schweizer Führerausweis umtauschen. Falls Sie ein Fahrzeug im Ausland besitzen und dies in die Schweiz importieren möchten, so haben Sie nach dem Einreisedatum ein Jahr Zeit, das Fahrzeug umschreiben zu lassen. Weitere Informationen und die notwendigen Formulare erhalten Sie im Verkehrssicherheitszentrum.

✉ info@vsz.ch, www.vsz.ch

→ Carsharing

Carsharing ist die organisierte gemeinschaftliche Nutzung eines oder mehrerer Autos. Fahrzeuge von Carsharing-Organisation finden Sie in der ganzen Schweiz. Grösster Anbieter ist Mobility mit über 2900 Fahrzeugen.

www.mobility.ch

→ Fahrradsharing

In vielen Nidwaldner Gemeinden stehen Ihnen Fahrräder zum Ausleihen zur Verfügung. Sie müssen sich über die «Nextbike»-App registrieren, die Ausleihe kostet CHF 2 pro Stunde.

www.nextbike.ch

ADRESSEN UND NOTFALLNUMMERN

→ Notfallnummern

Polizei	117/112
Feuerwehr	118/112
Sanitätsnotruf	144
Vergiftungsnotfälle	145
Rettungshelikopter REGA	1414

→ Adressen

Gesundheitsförderung und Integration
Marktgasse 3, 6371 Stans
041 618 75 90
✉ gfi@nw.ch
www.gfi.nw.ch
www.integration-nw.ch

→ Adressverzeichnisse

www.info-merkblatt.ch
www.local.ch
www.nw.ch > Online-Schalter > Rat und Hilfe

Gesundheitsförderung und Integration
Marktgasse 3, 6371 Stans
✆ 041 618 75 90
✉ gfi@nw.ch
☞ www.gfi.nw.ch
☞ www.integration-nw.ch

GESUNDHEITS
FÖRDERUNG
& INTEGRATION
NIDWALDEN

KIP
KANTONALE
INTEGRATIONSPROGRAMME

TRIART.CH
19-03-20-KNW-INFOBROSCHÜRE-AL